



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.204 dt.29.09.2000

**PER  
CELJE FONDI NGA TE ARDHURAT PER SHPERBLIMIN  
E SHERBIMIT TE DDD-s TIRANES**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.29.09.2000, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit “Për miratimin e fondit nga të ardhurat për shpërblimin e punonjësve të Shërbimit të DDD-s”, mbështetur në ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” në Republikën e Shqipërisë,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë çeljen e fondit prej 450 mijë lekë nga të ardhurat, për shpërblimin e punonjësve të Shërbimit të DDD-s Tiranë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ajo e Financës dhe Shërbimi i DDD-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**

